# DËSHMI ARKIVI

**A-476541**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Deklaratat e Ramës nga Rinasi, Erl Murati: Spektakël, kryeministri ishte i nervozuar |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/deklaratat-e-rames-nga-rinasi-erl-murati-spektakel-kryeministri-ishte-i-i106421` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 13:55:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 13:39:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f32ddb6b04cbd59e8fb8d9addfae05acecb05bdb825e49fe6dc23a5e0c7a4e6c` |
| TEKSTI | `7eec658c728f0ac40bd34c2cf91ab3ad32a67e78913ffaab4a51fed744fd2808` |
| PAMJA | `9bd6dcffa9848aeb81569ff1e485244bfb5817427758b0983c7b29568246e42a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a04ec3369282ad3d4a43f4bacbd1305381b4100b3998938851d0c3b092dc95e3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `282274d0ff18f09ea4854e79728659ffe2d6cd028bfa2085cb95da6ce0a699bb` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a04ec3369282ad3d4a43f4bacbd1305381b4100b3998938851d0c3b092dc95e3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Deklaratat e Ramës nga Rinasi, Erl Murati: Spektakël, kryeministri ishte i nervozuar

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 15:39



Analisti Erl Murati ka komentuar zhvillimet e fundit lidhur me dosjen e Vlora Hysenit, duke u ndalur te masa “arrest në shtëpi”, por edhe te regjistrimet e lidhura me Ergys Agasin.

I ftuar në "News 24", Murati ironizoi duke thënë se në rastin e Hysenit “çudia e madhe zgjati vetëm 3 orë”. Sipas tij, kjo lidhet me numrin e madh të skandaleve dhe akuzave që dalin vazhdimisht në publik dhe që përfundojnë duke mbivendosur njëra-tjetrën.

“Në rastin e Vlora Hysenit çudia e madhe zgjati vetëm 3 orë. Ne jemi mësuar si vend me skandale të tilla. E quajta ‘çudia më e madhe zgjat 3 orë’, jo për shkak se nuk janë habitur njerëzit. Por këtu ndodhin kaq shumë skandale, kohët e fundit dhe vitet e fundit, saqë skandalet mbivendosin njëri-tjetrin”, tha Murati.

Lidhur me regjistrimet e Ergys Agasit, Murati theksoi se ende qarkullojnë në formën e thashethemeve, raportimeve mediatike apo akuzave të opozitës, por shtoi se në materiale të tilla nuk ndodhet vetëm Hyseni.

“Këto janë në formën e thashethemeve dhe në formën e akuzave nga mediat dhe opozita. Këto raste janë ditur më herët. Ne që jemi profesionistë të fjalës, e dimë se jo vetëm Vlora Hyseni, por dhe drejtoresha të tjera janë në ato regjistrimet, videot e Ergys Agasit”, u shpreh Murati.

Analisti nuk përmendi emra konkretë të drejtuesve të tjerë, por argumentoi se edhe në raste të tjera, akuza të caktuara kanë qarkulluar fillimisht në publik dhe vetëm më vonë kanë pasur zhvillime të tjera.

“Do të kalojë koha deri sa të zyrtarizohen akuzat. Tuneli i Llogarasë, apo dhe akuzat për Agasin, kanë qenë akuza publike, si në rastin e opozitës”, u shpreh ai.

Murati komentoi gjithashtu qëndrimin e kryeministrit Edi Rama, duke iu referuar deklaratës së tij në Rinas. Sipas analistit, dalja publike e kreut të qeverisë kishte elementë spektakli, ndërsa shtoi se Rama dukej i nervozuar.

“E patë deklaratën për shtyp të Ramës në Rinas, ishte vetëm për spektakël. Ai ishte i nervozuar. Një drejtues qeverie mund të distancohej publikisht. Ai nuk ka asnjë detyrim ndaj Hysenit, nëse është i pastër”, tha Murati.

Gjithashtu, analisti kritikoi edhe mënyrën se si Rama reagoi ndaj masës së marrë nga SPAK, duke u shprehur se kryeministri përpiqet t’i mbrojë bashkëpunëtorët e tij për aq kohë sa mundet.

“Ai relativizoi dhe u mor një masë, sipas tij, e rëndë nga SPAK. Rama i mbron aq sa mund t’i mbrojë, si në rastin e Vlora Hysenit”, përfundoi Murati.

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 28 Shtator15:31

### [Bardhi takon Ambasadoren e re të Holandës në Shqipëri: Krimi dhe korrupsioni kanë kapur shtetin]

Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi ka zhvilluar një takim me ambasadoren e Mbretërisë së Holandës në Shq...

POLITIKE 28 Shtator15:13

### [Zhupa: I vetmi akt që i shërben sigurisë kombëtare është dorëheqja]

Kryetarja e Komisionit të Kulturës, Turizmit dhe Diasporës Ina Zhupa e nisi mbledhjen me një debat të fortë me socialistët p&...

POLITIKE 28 Shtator14:44

**Deklaratat skandaloze të kryeministrit, Garo: Edi Rama bëri sot, akt shantazhi politik në zemër të Europës**

Pas deklaratave skandaloze të kreut të qeverisë shqiptare gjatë ditës së sotme, ka reaguar Partia Demokratike. Sipas zëdh&...

POLITIKE 28 Shtator14:17

**Luftë për "Territor"/ "Doni ta votoni hartën e re për ta pasur për zgjedhjet!", Bozdo thirrje PS: Lërini urdhrat politikë!**

Deputeti i Partisë Demokratike, Enno Bozdo, ka kundërshtuar në Komisionin e Ligjeve mënyrën se si mazhoranca po procedon me reform&eu...

POLITIKE 28 Shtator12:48

**Blushi te Ligjet: Sot në konsultë, subjekte të filmave të Gysit. Harta e PS si tenderat e paracaktuar të Ramës e Ballukut**

Kreu i grupit parlamentar të PL-së, Tedi Blushi kundërshtoi në Komisionin e Ligjeve projektin e PS-së për reformën ter...

POLITIKE 28 Shtator12:35

**"Alibia e Ramës ka rënë", Bardhi: Të japë llogari për SHISH-in dhe Vlora Hysenin, përgjegjësia politike është e ti**

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka akuzuar kryeministrin Edi Rama për mungesë llogaridhënieje dhe p...

POLITIKE 28 Shtator11:50

**Ambasadorja e BE 'shuplakë' Ramës: Ambicia për mbylljen e negociatave deri në 2027 kërkon reforma**

Ambasadorja e BE në Tiranë, Sofia Moreira se la Sousa ka vënë theksin te procesi i integrimit evropian të Shqipërisë dhe ve...

POLITIKE 28 Shtator10:01

**Këshilli i Sigurisë në mbledhje, PD: Shkaktarët s'mund të jenë shpëtimtarë, kërkohet qeveri teknike**

Partia Demokratike thotë se mbledhja e sotme e Këshillit të Sigurisë lidhur me zhvillimet e fundit në vend pas arrestit të ish-k...

POLITIKE 28 Shtator09:39

**"Grekët e maqedonasit e gjetën gjuhën, ndërsa ne jo!"/ Fjalimi i Ditmir Bushatit 7 vite më parë në Parlament: Pasuria është grumbulluar në një rreth vicioz njerëzish**

Në atë kohë, Bushati e cilësonte Shqipërinë në një "udhëkryq të madh" dhe ngrinte një pyetje ...

POLITIKE 28 Shtator09:28

**Prençi: Vlora Hyseni nuk shkoi në takimin e Bakusë, nuk iu sekuestruan telefonat**

Teksa Presidenti i Republikës, Bajram Begaj ka thirrur mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare për skandalin e SHISH, të...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 27 Shtator

**"Kam vrarë vetëm 9"/ Njihuni me 'engjëllin e vd...**

Ajo është infermierja vrasëse që u bë famëkeqe shumë kohë përpara se Lucy Letby të dënohej me burg. Bever...

AKTUALITET 27 Shtator

**I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elba...**

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku ...

AKTUALITET 27 Shtator

**Lulëzimi i çiftit Ergys dhe Dorina Verdho/ Nga ...**

Çifti Ergys dhe Dorina Verdho duhet të merret si "shembull" nga familjet shqiptare për mënyrën sesi kanë shumëf...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

**Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!**

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

**video**



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**



**Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!**



**Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.